



VENDIM

Nr. 135 Datë 20.09.2012

MBI

**ANKIMIN ADMINISTRATIV TË CEZ SHPËRNDARJE SH.A NË
LIDHJE VENDIMIN NR. 128, DATË 11.09.2012, “PER PROCEDIMIN
ADMINISTRATIVE PER VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQERISE CEZ
SHPERNDARJE SH.A” TE BORDIT TE KOMISIONEREVE TE ERE**

Në mbështetje të nenit 9 pikat 1, 4 dhe nenit 64, pika 4, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 26, pika 1 të Ligjit nr. 10 279, date 20.05.2010 “Per kundravajtjet administrative”, nenit 25 pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 328 të Kodit të Procedures Civile, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.09.2012, mbasi analizoi ankimin e paraqitur nga CEZ Shpërndarje sh.a me shkresën nr. 5463/1, datë 18.09.2012, si dhe relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës,

Konstatoi se:

- Ligji nr. 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”, i ndryshuar, ne nenin 64 pika 4 percakton se “Shqyrtimi i kundravajtjeve administrative, ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve te Bordit behet sipas ligjit 10279, date 20.05.2010 “Per kundravajtjet administrative”.
- Ligjit nr. 10279, date 20.05.2010 “Per kundravajtjet administrative” ne nenin 26 te tij percakton se “Kunder vendimit per kundravajtjen administrative, qe parashikon denim me gjobe, te nxjerre nga organi i administrates, mund te behet ankim ne gjykate brenda 30 diteve nga data e njoftimit te vendimit”.

- Kodi i Procedurës Civile ne nenin 328 te tij percakton se “*Afati për paraqitjen e padisë ndaj një akti administrativ është tridhjetë dite nga dita e shpalljes ose e njoftimit te vendimit te organit me te larte administrativ, që ka shqyrtuar ankesën ne rruge administrative, përveç kur ligji parashikon ankimin e drejtpërdrejte në gjykatë. Në këtë rast afati fillon nga dita e shpalljes ose e njoftimit të aktit administrativ ndaj të cilit është paraqitur padia*”.
- Neni 25 i Kodit të Proçedurave Administrative përcakton detyrimin e organeve administrative për të verifikuar nëse kane ose jo juridiksionin për të vendosur mbi një çështje.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI :

1. Deklarimin e mungesës së juridiksionit të ERE per ankimin e CEZ Shperndarje “Mbi Vendimin nr. 128, date 11.09.2012 “Per Procedimin Administrativ per Vendosje Gjobe ndaj Shoqerise CEZ Shperndarje sh.a”;
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë CEZ Shpërndarje sh.a për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.